

## **Raport individual për rezultatet e konsultimeve publike për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

### **1. Titulli i draft aktit**

Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

### **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Konsultimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.*

*Konsultimi elektronik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar u zhvillua në datat 06.07.2022-26.07.2022 dhe 26.10.2022 - 22.11.2022)<sup>1</sup>. Po ashtu janë zhvilluar takimet konsultative me grupet e interesit në muajt korrik-shtator 2022.*

### **3. Metoda e konsultimit**

*Metodat e përdorura për konsultimin publik:*

- 1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK;*
- 2. Tryeza të konsultimit me ekspertë dhe grupet e interesit<sup>2</sup>.*

*Ndryshimet ligjore dhe strukturore në legjislacionin e inspektimit janë konsultuar fillimisht përmes takimeve konsultative paraprake me ekspertë individualë dhe grupet e interesit, dhe më pas përmes publikimit në RENJK.*

---

<sup>1</sup> Projektligji është publikuar dy herë në regjistrin elektronik të konsultimeve me kërkesë të Kryeministrisë

<sup>2</sup> Sindikatat, Shoqëria Civile dhe Donatorët, të gjitha Bashkitë dhe përfaqësues të kopshteve private.

*Kontributet janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, nga grupet e interesit dhe ekspertë të fushës së arsimit parauniversitar dhe shkresa zyrtare si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara kryesisht pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat janë mbledhur nga grupi i punës i ngritur në MAS për hartimin e projektligjit.*

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Procesi i hartimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”” është shoqëruar me një komunikim shumë intensiv bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*

*Fillimisht, procesi i hartimit të ndryshimeve në ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka nisur nga propozimi për kthimin e shkollave speciale në Qendra Burimore, si një hap thelbësor për përmirësimin e arsimit të nxënësve me aftësi të kufizuara. Krahas këtij propozimi në vijim janë parë të arsyeshme përfshirja dhe përmirësimi i politikave të arsimit parauniversitar që lidhen me implementimin në ligj të konceptit të shkollave të bashkuara, edukimin dhe promovimi i talenteve në arsimin bazë, jo vetëm nga shkollat e drejtimit të orientuar, por edhe nga shkollat klasike, përcaktimi i dispozitave ligjore për pranimin, emërimin, pezullimin dhe largimin nga një vend pune për mësuesin në dispozicion, përmirësimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e arsimit dhe konkretisht në fushën e monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit të institucioneve arsimore publike dhe jopublike, si dhe sigurimi i mbrojtjes për nxënësit, duke ndaluar përfshirjen e personave (mësuesve) në sistemin arsimor, të cilët janë dënuar për vepra penale që lidhen me të mitur, apo institucione arsimore parauniversitare, pavarësisht rehabilitimit të tyre.*

*Më poshtë, gjeni në një përmbledhje të takimit konsultativ që janë zhvilluar nga muaji korrik 2022 deri në nëntor 2022, të cilat janë të pasqyruara edhe në tabelën e konsultimit që i bashkëlidhet praktikës së projektligjit.*

*Regjistri i Konsultimeve Publike: Data e hapjes: 06.07.2022- Data e Mbylljes: 26.07.2022*

*Me kërkesë të Kryeministrisë është ripublikuar për konsultim publik në datat 26.10.2022 - 22.11.2022.*

*DPAP, DRAP dhe ZVAP 12.07.2022- gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me DPAP, DRAP, ZVAP dhe IAP, u bënë pyetje lidhur me statusin “ Inspektor”, duke biseduar që trajtimi i punonjësve të cilët do kryejnë inspektime, monitorime dhe vlerësime të jenë konform Ligjit për Inspektimin. Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me DPAP, DRAP, ZVAP dhe IAP, u bënë pyetje lidhur me përfshirjen e një përfaqësuesi të ZVAP-ve në komisionet e përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave.*

KKAP 13.07.2022-Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, u diskutua lidhur me përfshirjen e partnerëve socialë drejtpërdrejt në ligj.

KKP 13.07.2022- Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Këshillin Kombëtar të Prindërve, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në periudhën e verës apo përfshirjen e mësuesëve ndihmës në kopshte për të mbështetur këtë kategori në zhvillimin e tyre. Qendrat Burimore do të mbështesin komunitetin e nxënësve me aftësi të kufizuara, pavarësisht llojit të vështirësisë apo institucionit arsimor që kanë përzgjedhur për arsimimin e tyre, me qëllim përgatitjen dhe integrimin e tyre në shoqëri, duke nxitur rritjen e rezultateve akademike nëpërmjet përgatitjes profesionale dhe shërbimeve mbështetëse.

Parlamentin i Nxënësveve 13.07.2022-Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Parlamentin e nxënësve, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me transportin e nxënësve dhe përfaqësuesve të parlamentit të nxënësve në aktivitetet e tij, zvogëlimin e numrit të përzgjedhjes së teksteve dhe tekstet e huaja janë nivel më i ulët se niveli i disa nxënësve në arsimin parauniversitar, si dhe kufizimi I të drejtave të nxënësve në raport me mësuesin pasi për shkak të të drejtave të dhënave nxënësit nuk respektojnë figurën e mësuesit. Për të cilat u sqaruan se një pjesë e tyre nuk janë të përfshira në ligj por në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Sindikatat 13.07.2022-Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Sindikatat, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me përfshirjen e ndalimit për ushtrimin e profesionit të mësuesit për personat që kanë kryer vepra penale që lidhen me nxënësit apo institucionet arsimore parauniversitare, moshën e pranimit në klasën e parë si dhe përfshirjen e përfaqësuesve të ZVAP në komisionin e emërimit të drejtorit të IAP-ve. Nuk kishte sugjerime që kërkonin ndryshime në ligj, pyetjet u sqaruan nga grupi i punës në takim.

Shoqëria Civile 15.07.2022-Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Shoqërinë Civile, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me çështjet si vijon:  
-Regjistrimin e nxënësve të pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla, raportimin e braktisjes së tyre shkollore, rishikimi I teksteve për të përfshirë kulturën rome dhe egjiptiane. Detyrimin për të regjistruar fëmijët në shkollë dhe për të ndjekur arsimin bazë dhe përfshirja si të detyrueshëm të arsimit të mesëm të lartë. Monitorimi i shkollave për efekt të raportimit të braktisjes shkollore, publikimi I shifrave në nivel rajonal dhe vendor. U propozua marrja në konsideratë të diplomave master në leadership, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të shkollës së drejtorëve. Në këtë mënyrë drejtorët të cilët nuk kanë shkollën e drejtorëve, por kanë diplomë për menaxhim arsimit ose leadership të konsiderohen të barabartë me ata që kanë kryer shkollën e drejtorëve.

Donatorët 15.07.2022-U propozua shtimi i përkufizimeve për drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar, konkretisht një përkufizim për drejtorin dhe nëndrejtorin. Të shtohet një nen i posaçëm për nëndrejtorin. Në nenin 55 të përfshihet edhe pezullimi dhe ulja në detyrë. Emërimi i drejtorit dhe nëndrejtorit të mos jetë në përzgjedhjen e dy kandidatëve me më shumë pike.

Të gjitha bashkitë shtator 2022-Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me përfaqësuesit e bashkive u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me propozimet e projektligjit.

Shkolla e drejtoresve me shkresë zyrtare propozoi dispozita kalimtare që lidhen me shtyrjen e afateve të trajnimit të kandidatëve për drejtorë dhe drejtuesve në detyrë.

Përfaqësues të kopshteve private: Kanë përcjellë sugjerime për drejtuesin didaktik në arsimin parashkollor. Sugjerojnë që në pikat 2 dhe 4 të nenit 55/1 të bëhen ndryshimet si vijon:

Lejimin e administratorëve të kopshteve private.

Lejimin e drejtuesve didaktikë aktualë që kanë titullin mësues të kualifikuar dhe e kanë ushtruar këtë detyrë për më shumë se 10 vjet.

Lejimin e pronarëve të kopshteve që kanë arsim parashkollor që e kanë ushtruar këtë profesion para diplomimit të tyre, por nuk kanë 5 vjet eksperiencë pune.

Pronarët e kopshteve që kanë studiuar në Fakultetin e Shkencave Sociale.

Pronarët që kanë një fakultet tjetër, por kanë ndërtuar eksperiencën e tyre tashmë në drejtim.

Mësuesit e ciklit të ulët ose të degëve mësuesi (cikli i ulët, gjuhë letërsi, psikologji, pune letërsi).

## **5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Nga konsultimi publik i kryer në Regjistrin elektronik në zbatim të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk ka pasur komente apo propozime të caktuara mbi përmbajtjen e projektligjit. Komentet janë përcjellë gjatë takimeve konsultative dhe me shkresa zyrtare.*

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Konkurrimi për drejtor të	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me DPAP, DRAP,	DPAP, DRAP dhe ZVAP	Pranuar	Është marrë në konsiderstë dhe

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
institucioneve arsimore parauniversitare	ZVAP dhe IAP ,u bënë pyetje lidhur me përfshirjen e një përfaqësuesi të ZVAP-ve në komisionet e përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave. Në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2022 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucioneve publike parauniversitare” është diskutuar mbi një ndryshim duke propozuar shtim, për të përfshirë në këtë proces përfaqësues nga ZVAP.			është shtuar një përfaqësues nga njësisia arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar në praktikën e projektligjit
Përcaktimi i kompetencave të institucionit përgjegjës për inspektimin	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me DPAP, DRAP, ZVAP dhe IAP, u bënë pyetje lidhur me statusin “ Inspektor”, duke biseduar që trajtimi i punonjësve të cilët do kryejnë inspektime, monitorime dhe vlerësime të jenë konform Ligjit për Inspektimin.	DPAP, DRAP, ZVAP dhe IAP	Pranuar	Ky propozim u mor në konsideratë dhe u bënë disa shtesa në disa pika të neneve të kreut XIII, duke saktësuar kompetencat e punonjësve

<p>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
				<p>përgjegjës për inspektimin si inspektorë për të marrë masat e përcaktuara në këtë kre.</p>
<p>Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara</p>	<p>Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Këshillin Kombëtar të Prindërve, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në periudhën e verës apo përfshirjen e mësuesëve ndihmës në kopshte për të mbështetur këtë kategori në zhvillimin e tyre. Qendrat Burimore do të mbështesin komunitetin e nxënësve me aftësi të kufizuar, pavarësisht llojit të vështirësisë apo institucionit arsimor që kanë përzgjedhur për arsimimin e tyre, me qëllim përgatitjen dhe</p>	<p>KKP 13.07.2022</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Sugjerimet përfshihen në kuadër të parashikimeve për Qendrat Burimore</p>

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	integrimin e tyre në shoqëri, duke nxitur rritjen e rezultateve akademike nëpërmjet përgatitjes profesionale dhe shërbimeve mbështetëse.			
Diskutim në tërësi	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Parlamentin e nxënësve, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me transportin e nxënësve dhe përfaqësuesve të parlamentit të nxënësve në aktivitetet e tij, zvogëlimin e numrit të përzgjedhjes së teksteve dhe tekstet e huaja janë nivel më i ulët se niveli i disa nxënësve në arsimin parauniversitar, si dhe kufizimi I të drejtave të nxënësve në raport me mësuesin pasi për shkak të të drejtave të dhënave nxënësit nuk respektojnë figurën e mësuesit. Për të	Parlamentin i Nxënësve 13.07.2022	Pranuar	Nuk kishte sugjerime që kërkonin ndryshime në ligj, pyetjet u sqaruan nga grupi i punës në takim.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	cilat u sqaruan se një pjesë e tyre nuk janë të përfshira në ligj por në aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.			
Procedimi i shkeljeve disiplinore të mësuesve	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, në mbështetje të Ligjit nr. 69/2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar u diskutuar për shtim të një nen me përmbajtje: “ Në ZVAP të ngrihet komisioni i disiplinës, i cili merr në shqyrtim rastet e shkeljeve nga mësuesit në institucionet arsimore parauniversitare”.	KKAP 13.07.2022	Refuzuar	Ky sugjerim nuk u mor në konsideratë pasi për rastet e shkeljeve të mësuesve është ngritur Komisioni për vlerësimin Psiko-social pranë ZVAP-së me udhëzimin nr. 12 datë 16.6.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.
Riorganizimi i drejtorive	Gjatë zhvillimit të takimit me DPAP, DRAP, ZVAP dhe	DPAP, DRAP, ZVAP dhe IAP	Refuzuar	Nuk u mor në konsideratë pasi



Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
rajonale dhe zyra vendore të arsimit parauniversitar.	IAP, u diskutua problematikat e organizimit dhe funksionimit të ZVAP Tiranë. Në këto kushte u propozua që ZVAP Tiranë, në zbatim të VKM nr. 99, datë 27.02.2019, kreu 3, pika 2 parashikon: “ Drejtoritë Rajonale krijohen kur mbulojnë jo më pak se 4000(mijë) punonjës”. Në zbatim të saj, ZVAP Tiranë, ka nën juridiksionin e saj 5 000(mijë) punonjës, 144 IAP publike, 60 IAP jopublike dhe 165 institucione parashkollore publike dhe jopublike.			nuk lidhet me ndryshime në ligj, por me VKM 99/2019
Diskutim i përgjithshëm	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Sindikatat, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me përfshirjen e ndalimit për ushtrimin e profesionit të mësuesit për personat që kanë kryer vepra penale që lidhen me nxënësit	Sindikatat	Pranuar	Nuk kishte sugjerime që kërkonin ndryshime në ligj, pyetjet u sqaruan nga grupi i punës në takim

<p>Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i></p>	<p>Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i></p>	<p>Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i></p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>apo institucionet arsimore parauniversitare, moshën e pranimit në klasën e parë si dhe përfshirjen e përfaqësuesve të ZVAP në komisionin e emërimit të drejtorit të IAP-ve.</p>			
<p>Përfshirja e gjuhës rome në shkolla</p>	<p>Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Shoqërinë Civile, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me çështjet si vijon: - Regjistrimin e nxënësve të pakicave rome dhe egjiptiane në shkolla, raportimin e braktisjes së tyre shkollore, rishikimi I teksteve për të përfshirë kulturën rome dhe egjiptiane. Detyrimin për të regjistruar fëmijët në shkollë dhe për të ndjekur arsimin bazë dhe përfshirja si të detyrueshëm të arsimit të mesëm të lartë.</p>	<p>Shoqëria Civile</p>	<p>Pranuar .</p>	<p>ASCAP informoi se po punohet për përgatitjen e modulit të gjuhës rome</p>

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Shtimi i përkufizimeve për drejtuesit e IAP-ve.	<p>Monitorimi i shkollave për efekt të raportimit të braktisjes shkollore, publikimi I shifrave në nivel rajonal dhe vendor.</p> <p>U propozua shtimi i përkufizimeve për drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar, konkretisht një përkufizim për drejtorin dhe nëndrejtorin. Të shtohet një nen i posaçëm për nëndrejtorin. Në nenin 55 të përfshihet edhe pezullimi dhe ulja në detyrë. Emërimi i drejtorit dhe nëndrejtorit të mos jetë në përzgjedhjen e dy kandidatëve me më shumë pike.</p>		Refuzuar	Nuk u mor në konsideratë pjesërisht pasi nuk është e nevojshme të jetë një përkufizim konkret pasi është i përcaktuar në nenin përkatës të drejtorit. Propozimi për dy kandidatët me më shumë pike nuk u mor në konsideratë pasi vlerësohet se drejtori i DRAP për sa kohë ka kompetencën për ta emëruar duhet edhe

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me Shoqërinë Civile, u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me çështjet si vijon: Mbi marrjen në konsideratë të diplomave Master në lidhshmëri, të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të shkollës së drejtorëve. Në këtë mënyrë drejtorët të cilët nuk kanë shkollën e drejtorëve, por kanë diplomë për menaxhim arsimit ose lidhshmëri të konsiderohen të barabartë me ata që kanë kryer shkollën e drejtorëve.		Refuzuar	të përzgjedhë njërin prej dy kandidatëve të propozuar nga komisioni.  Ky sugjerim nuk u mor në konsideratë pasi certifikimi i drejtuesve është kompetencë e Shkollës së Drejtorëve sipas ligjit jo e institucioneve të arsimit të lartë.
Trajnimi i drejtorëve të shkollave	Shkolla e drejtorëve propozoi dispozita kalimtare që lidhen me shtyrjen e afateve të trajnimit të kandidatëve për drejtorë dhe drejtuesve në detyrë.	Shkolla e drejtorëve	Pranuar	Këto sugjerime u morën në konsideratë dhe u reflektuan në praktikën e projektligjit

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Prezantimi i projektligjit  Nuk kishte sugjerime	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ me përfaqësuesit e bashkive u bënë pyetje dhe u diskutua lidhur me propozimet e projektligjit.	Të gjitha bashkitë	Pranuar	Nuk ka pasur sugjerime shtesë.
Sugjerime për drejtuesin didaktik	Kanë përcjellë sugjerime për drejtuesin didaktik në arsimin parashkollor. Sugjerojnë që në pikat 2 dhe 4 të nenit 55/1 të bëhen ndryshimet si vijon: Lejimin e administratorëve të kopshteve private. Lejimin e drejtuesve didaktikë aktualë që kanë titullin mësues të kualifikuar dhe e kanë ushtruar këtë detyrë për më shumë se 10 vjet. Lejimin e pronarëve të kopshteve që kanë arsim parashkollor që e kanë ushtruar këtë profesion para diplomimit të tyre, por nuk kanë 5 vjet eksperiencë pune.	Përfaqësues të Kopshteve private	Refuzuar	Funksionet që kryen drejtuesi i institucionit arsimor parashkollor janë administrative dhe pedagogjike. Funksionet pedagogjike të drejtuesit përfshijnë aspekte që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe përditësimin e praktikave të mësimdhënies, me zbatimin e kurrikulës dhe me edukimin cilësor të fëmijëve për pasojë

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	<p>Pronarët e kopshteve që kanë studjuar në Fakultetin e Shkencave Sociale.</p> <p>Pronarët që kanë një fakultet tjetër, por kanë ndërtuar eksperiencën e tyre tashmë në drejtim.</p> <p>Mësuesit e ciklit të ulët ose të degëve mësuesi (cikli i ulët, gjuhë letërsi, psikologji, pune letërsi)</p>			<p>është e nevojshme që ai të jetë i përgatitur në fushën e arsimit parashkollor.</p> <p>Drejtori modelon të nxënit personal dhe profesional që dukshëm lidhet me vizionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p>Ligji i arsimit të lartë nr. 80/2015 në nenin 83 ka parashikuar programet e studimit në fushën e mësuesisë programet e studimit në fushën e mësuesisë për arsim parashkollor dhe arsim fillor,</p>

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				<p>organizohen në dy cikle: a) program i ciklit të parë, “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor; b) program i ciklit të dytë “Master profesional”, që formon mësues të arsimit fillor. Duke parashikuar programe të ndryshme për secilin prej profileve.</p> <p>Po ashtu, ligji nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i</p>

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				<p>ndryshuar ka parashikuar si profesion të rregulluar mësuesinë në pikën 3 të nenit 6 parashikon ndër të tjera se 3. Ushtrimi i një profesioni të rregulluar bëhet në përputhje me parimin e korrektësisë dhe cilësisë së shërbimeve për mbrojtjen e përfituesit të shërbimit e të interesave publikë, duke garantuar ushtrimin korrekt e ligjor të profesionit, pavarësisht nga mënyra apo forma e ushtrimit të tij,</p>



Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
				prandaj një mësues i arsimit parashkollor duhet të jetë i arsimuar në këtë fushë që t'i shërbejë sa më mirë mbrojtjes së interesit të publikut.